



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.54/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Bajram Rexhahmetaj duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(VV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Suharekë, për shkak të vendosjes së posterit në objektin publik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje(VV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.54/2017, të datës 24.09.2017, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Suharekë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 850.00 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 24.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje(VV) me të cilën pretendon se me datën 23.09.2017, në rrugën “Endrit Kavaja” në Suharekë, ish-in vendosur poster i Anëtarit për Kuvendin Komunale në Suharekë, Kushtrim Kuçi nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të ngjitur në objektin publike përkatësisht në një trafostacion të rrymës. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur katër(4) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 25.09.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se paraqiten mungesa absolute për vendet e dedikuara për reklamime politike dhe posterit i vendosur nuk mund të konsiderohet si shkelje sipas dispozitave të LPZ-së, meqenë se vendosja e tyre nuk cenon objektin dhe as funksionalitetin e tij, dhe se pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku janë larguar pllakatat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për Anëtar për Kuvendin Komunalë në Suharekë, Kushtim Kuçi nga radhët e subjektit politik LDK, janë ngjitur në trafostacion publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për Anëtar për Kuvendin Komunalë në Suharekë, nga subjektit politik i LDK-së, janë vendosur në objektin publik përkatësisht në trafostacion. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 25.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 54/2017 më datën 26.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.